

# Pasqyrat financiare të vitit 2020

## INFORMACION I PERGJITHSHEM

Shoqëria "EDIANI" sh.p.k është krijuar sipas aktit të themelimit më datë 24/01/2019 me kapital themeltar 603.000 lekë. Kjo shoqëri është krijuar mbështetur në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Aksioner të shoqërisë janë:

1- Edi-Energji me 100% të aksioneve.

Shoqëria e ka selinë e saj qendrore në Mirditë, Shengjin Fan, sipërfaqe toke me Nr. Pasurisë 639, zona kadastrale 3345, ne proin "Kenell". Objekti i veprimtarisë së saj është:

- Financim, projektim, ndertim, venie ne pune, administrim, mirembajtje e Hidrocentralit Shengjon me vendodhje ne Fan Mirdite.

Shoqëria është e regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë me Nr. NIPT-i L39523001J. Kjo shoqëri është krijuar mbështetur në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

### 1. PËRMBLEDHJE E PARIMEVE KRYESORE TË KONTABILITETIT

#### a. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë përgatitur, sipas parimit të materialitetit, në përputhje me legjislacionin shqiptar mbi kontabilitetin, i cili përmban rregulla dhe interpretime në përshtatje të Ligjit Nr. 7661, datë 19 janar 1993 "Mbi Kontabilitetin" dhe "Parimeve të përgjithshme të kontabilitetit", aprovuar nga Këshilli Ministrave, dhe ndryshimeve të Ligjit Nr. 9228 datë 29 prill 2004 "Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare. Pasqyrat financiare të kompanisë janë përgatitur në bazë të kostos historike. Të dhënat janë të shprehura Lek Shqiptar (LEK), e cila është monedha raportuese për kompaninë.

#### b. Aktive afatgjata materiale dhe jo materiale

Aktivet afatgjata materiale janë regjistruar në llogaritë e kompanisë me koston e blerjeve. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjëndjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndertimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

#### *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare apo zbritëse të amortizimit, mbi jeten e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.

Normat e amortizimit dhe metodat e përdorura janë si më poshtë:

| Kategoria                      | Metoda e amortizimit     | Norma e amortizimit |
|--------------------------------|--------------------------|---------------------|
| Makineri dhe pajisje           | Mbi vlerën kontabël neto | 20%                 |
| Mobilje dhe orendi             | Mbi vlerën kontabël neto | 20%                 |
| Mjete transporti               | Mbi vlerën kontabël neto | 20%                 |
| Pajisje zyresh dhe informatike | Mbi vlerën kontabël neto | 25%                 |

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në cdo datë raportimi. Aktivët afatgjatë jomateriale njihen atëherë kur është e mundur që të përfitime ekonomike do të sigurohen në të ardhmen në lidhje me këto aktive dhe kostoja e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme.

#### c. Llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet

Llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet janë paraqitur në bilanc bazuar në shumën e faturave të marra nga furnitorët.

#### d. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë arkën në LEK dhe në monedhë të huaj si dhe paratë e mbajtura në banka në Shqipëri.

#### e. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në LEK dhe regjistrohen me kursin e këmbimit të vendosur në datën e transaksionit. Mjetet monetare në monedhë të huaj konvertohen në LEK me kursin e këmbimit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë në datën e bilancit. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të kompanisë si diferenca të realizuara nga kursi këmbimit.

Zëra të tjerë jo monetarë në monedhë të huaj konvertohen në LEK duke përdorur kursin e këmbimit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë në datën e bilancit. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të kompanisë si diferenca të realizuara nga kursi këmbimit.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e zërave të bilancit në monedhë të huaj ishin si më poshtë (në Lek):

| Emertimi | 31 Dhjetor 2020 |
|----------|-----------------|
| 1 EUR    | 123.70          |
| 1 USD    | 100.84          |

#### f. Të ardhurat

Të ardhurat njihen në masën që është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike do të vijnë kompanisë dhe këto përfitime mund të maten në mënyrë të besueshme. Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato kryhen. Të ardhurat dhe shpenzimet regjistrohen në pasqyrat financiare të periudhës të cilës i përkasin.

#### g. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin është llogaritur në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për tatimin mbi fitimin për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2020. Tatimi mbi fitimin përfshin tërësisht tatimin mbi fitimin e llogaritur për periudhën kontabël. Tatimi aktual mbi fitimin llogaritet si 5% e fitimit të tatueshëm të përcaktuar në legjislacionin e kontabilitetit dhe legjislacionin tatimor në Shqipëri.

#### **h. Parimi i vijimesise**

Pasqyrat financiare sipas legjislacionit janë përgatitur sipas parimit e vijimesisë, i cili parashikon realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve gjatë ecurisë normale të biznes. Te dhenat e kontabilitetit janë mbajtur duke qene ne perputhje me parimet e pergjithshme te kontabilitetit, ne menyre te vecante me bazen e matjes me kosto historike, parimin e kontabilitetit rrjedhes, konceptin e kujdesit dhe me supozimin e biznesit ne vijimesi.

#### **i. Shenime të tjera shpjeguese**

Ngjarje të ndodhura pas datës së bilancit për të cilat bëhen rregullime apo ngjarje të ndodhura pas datës se bilancit për të cilat nuk behen rregullime nuk ka.

Gabime materiale të ndodhura në periudhat kontabël të mëparshme të konstatuara gjatë periudhes raportuese nuk ka.

**Miratoi**

**Administratori**

**LLESH BOÇI**

